



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECANI



Komiteti për Komunitete  
02. Nr. XI  
Deçan, dt. 08.12.2023

## PROCESVERBAL

Mbledhja e njëmbëdhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08.12.2023. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, Policia e Kosovës, OSBE, dhe UNMIK-u. Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Raport nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth gjendjes aktuale;
4. Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2024;
5. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Artan Ismajlaj, zyrtar për IE pranë ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se kjo zyrë, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, ka pasur kërkesa nga qytetaret e komunitetit jo shumice për ndihme rreth pajisjes me dokumente personale ku të njëjtit janë ndihmuar nga personeli i ZLK-së.

III. Raport nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth gjendjes aktuale:

Sa i përket raportit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth gjendjes aktuale: e pranishme në këtë takim ishte Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Znj, Agnesa Vokshi.

Ajo i informoj se ne Komunën e Deçanit operon QKMF-ja në Deçan, QMF në fshatrat Irzniq, Isniq, Strellc dhe AMF në Gramaçel.

Të njëjtat posedojnë infrastrukturë shumë të mirë dhe shërbime cilësore.

Të njëjtat ofrojnë analiza laboratorike.

Vlen te ceket se ketë vit kemi mare edhe një ultrazë donacion.

Ne QKMF-në kryesore në Deçan punon edhe Reparti i Urgjencës i cili ofron shërbime 24 orësh për qytetaret e komunës së Deçanit.

Sa ju përket shërbimeve që ofrohen nga këto institucione pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë kanë qasje të plotë pa asnjë dallim.

Si problem, sfidë vlen të ceket lista e barnave esenciale ku ka mungesa e për të cilën përgjegjëse është Ministria e Shëndetësisë.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se sa ka pas fushatë për vaksinimin për gripin sezonal.

Drejtoresha e njoftoj se kanë bere fushate përmes mjeteve te informimit dhe përmes rrjeteve sociale dhe formave te tjera.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z, Shkelzen Berisha i njoftoj te pranishmit rreth Raportit vjetor të punës i cili pas leximit u aprovua njëzëri.

Kurse hartimi i planit të punës për vitin 2024 të kryhet gjatë muajit dhjetor 2023.

Te ndryshme: Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se çka është duke u bere që tu dilet ne ndihme familjeve nga komunitete jo shumice që e kanë gjendjen jo te mire ekonomike rreth ndihmës me dru ose mjete tjera alternative për ngrohje gjate stinës së dimrit. E njëjta u njoftua se për këtë problem është kujdesur Ministria e Financave e cila do te subvencionoj me nga 120 euro familjet në nevojë.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Proces mbajtësi:

Artan Ismajlaj

Kryesuesi i mbledhjes:

Shkelzen Berisha



Komiteti për Komunitete  
02. Nr. IX  
Deçan, dt. 13.10.2023

## PROCESVERBAL

Mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 13.10.2023.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja dhe OJQ "TOKA".

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Raport nga Koordinator i Zyrës për Komunitete z, Shaban Pejçinović;
4. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet me një vërejtje nga Znj, Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK, procesverbali i mbledhjes së fundit ishte shumë i mangët nga përmbajtja.

Artan Ismajlaj-ZIE sqaroi se ne mungesë të tij pasi që ishte në një takim tjetër me përfaqësuesit e KFOR-it Italian kishte ndodhur ky lëshim në pamundësi të zëvendësimit nga ndonjë zyrtar tjetër.

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoi për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji, ka pasur dy (2) raste të personave të riatdhësuar ka pasur konsultime me qytetarë nga komunitetet për nevoja të ndryshme kryesisht rreth ndihmës në pajisje me vërtetime identiteti për nevoja të studimeve, të cilëve ju është ofruar ndihma nga zyra e ZKK-së.

III. Raport nga Koordinator i Zyrës për Komunitete z, Shaban Pejçinović:

Sa i përket raportit nga Koordinator i Zyrës për Komunitete z, Shaban Pejçinović: i njëjti raportoi për punët që janë kryer nga kjo zyre që nga fillimi i vitit 2023, e të cilat konsistojnë kryesisht në projekte infrastrukturore dhe vizita të ndryshme në teren.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja tha se pas vizitës së fundit neper disa shkolla nxënësit nga komunitetet jo shumica kanë ngritur shqetësim për vështirësitë e furnizimit me tekste shkollore.



Komiteti për Komunitete  
02. Nr. X  
Deçan, dt. 10.11.2023

## PROCESVERBAL

Mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 10.11.2023.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Raport nga Kryetari i Komunës së Deçanit për gjendjen e përgjithshme të komunitetit jo shumicë;
4. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoij për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur vizita neper vendbanimet ku gravitojnë më shumë komunitetet jo shumicë siç janë fshatrat Gramaçel, Dubovik, Shaptej dhe lagjen Pemishte.

Ku janë njoftuar për së afërmi me problemet që përballen ky komunitet që kryesisht kanë qenë probleme të infrastrukturës: ndriçim publik, asfaltim etj.

III. Raport nga Kryetari i Komunës së Deçanit:

Sa i përket raportit nga Kryetari i Komunës së Deçanit: i njëjti ndodhej në një takim me një nga Ambasadoret e Korit Diplomatik të Akredituar në Kosovë.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Shkelzen Berisha i njoftoj te pranishmit rreth vizitës së Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal z. Elbert Krasniqi me bashkëpunëtor dhe Kryetarit të Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj me rastin e përrurimit te disa rrugëve te asfaltuara ne lagjen Pemishte e banuar nga komunitetit jo shumicë.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj të njoftohet se si janë mundësit që të ju ndihmohet me dru për ngrohje familjeve të komunitetit jo shumicë që e kanë gjendjen jo të mirë ekonomike në prag të stinës së dimrit.

Z, Shaban Pejçinović i njoftoj të pranishmit se këtë shqetësim e ka ngrit në instancat më të larta Komunale dhe pret një njoftim rreth kësaj kërkesë ditëve në vijim.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z, Shkelzen Berisha i njoftoj të pranishmit rreth ndihmës që po ju ofrohet nxënësve të komunitetit jo shumicë rreth aplikimit për bursat e shkollimit nxënësve dhe studentëve të komunitetit jo shumicë.

Kryesuesi i falenderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:  
Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes  
Shkelzen Berisha

